



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2014
Nr. Dok. 201400439/9

Lënda: *Rekomandohet zbatimi i dispozitave ligjore për rastet e vlerësimit të ushtarakëve që do të kualifikohen jashtë vendit, ndryshimi i Urdhërit Nr.1587, datë 30.09.2011 dhe marrja parasysh e mundësisë për të përsëritur vlerësimin e ushtarakut që do të ndjekë "Shkollën e Luftës", kualifikim i organizuar nga shteti Frances*

Drejtuar: **Ministrit të Mbrojtjes**
Zj. Mimi KODHELI

Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura
Gjeneralmajor Jeronim BAZO

TIRANË

E nderuar Zj. Kodheli,

I nderuar Z. Bazo,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë efektivi i FA Major F. A., i cili pretendon se, në kundërshtim me ligjin i është mohuar e drejta për të ndjekur "Shkollën e Luftës", kualifikim që do të kryhet në Francë. Ky kualifikim organizohet nga shteti Frances dhe Shqipërisë i është akorduar vetëm një vend. Përzgjedhja e kandidatës fillimisht kushtëzohej nga niveli i gjuhës frënge që do të testohej nga Ambasada Francese. Pas këtij testi, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm i janë paraqitur për përzgjedhje tre kandidatura, Major F. A., Nënkolonel S. L. dhe Nënkolonel E. D.. Kandidatura e përzgjedhur për të ndjekur kursin është ajo e Nënkolonel S. L.

Për verifikimin e kësaj ankese iu kërkuan shpjegime Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe Ministrisë së Mbrojtjes si dhe u analizua legjislacioni që normon vlerësimin e ushtarakëve që do të kualifikohen jashtë vendit (Ligji Nr 9171, datë 22.01.2004 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA" dhe Urdhëri Nr.1587, datë 30.09.2011 "Politikat dhe procedurat standard të veprimit për menaxhimin e arsimimit dhe kualifikimit jashtë vendit të personelit të FA").

Në përfundim të verifikimit rezultoi se, vlerësimi i ushtarakut që do të ndiqte "Shkollën e Luftës" është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Referuar nenit 21 të Ligjit “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA”, autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e ushtarakëve që do të kualifikohen jashtë vendit janë komisionet e karrierës. Për rastin në fjalë është Komisioni i Lartë i Karrierës. Veprimtaria e Komisionit të Lartë të Karrierës normohet në Urdhërin Nr. 621, datë 03.04.2013 “Rregullore për funksionimin, detyrat dhe të drejtat e Komisionit të Lartë dhe Komisioneve të Zakonshme të Karrierës në FARSH”. Ndërsa vlerësimi i ushtarakëve që do të ndiqnin “Shkollën e Luftës” është bërë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe jo sipas kritereve ligjore.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA, komisionet e karrierës i përfundojnë procedurat e punës brenda muajit qershor të çdo viti (Ligji “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA” (neni 21/7). Ftesa për të ndjekur “Shkollën e Luftës” i përket datës 27.08.2013. Meqenëse komisionet e karrierës e kishin përfunduar procedurën për vitin 2013, kompetenca për përzgjedhjen e kandidaturës për të ndjekur “Shkollën e Luftës” është e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA. Ndërsa për pyetjen, se cilat janë kriteret e përzgjedhjes të kandidaturës thuhet se, kriteret janë ato të vendosura nga Zyra e Atasheut Ushtarak të Republikës së Francës në Tiranë: kandidati të jetë oficer me gradën major-nënkolonel dhe të zotërojë shumë mirë gjuhën frënge.

Për sa i përket autoritetit përgjegjës për vlerësimin e ushtarakut që do të ndjekë kualifikimin jashtë vendit, Ligji “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA” përcakton se ky autoritet është komisioni i karrierës. Neni 21/7 vendos afat për përfundimin e punës të komisionit por, nuk vendos afat për fillimin e punës së tij dhe nuk përjashton mundësinë që ai të mblidhet në raste të veçanta siç është ai i kualifikimit për të ndjekur “Shkollën e Luftës”.

Për sa i përket kritereve për të ndjekur “Shkollën e Luftës”, kriteret e vendosura nga Zyra e Atasheut Ushtarak të Republikës së Francës në Tiranë janë kritere fillestare dhe nga ushtarakët e testuar, tre prej tyre i kanë plotësuar ato. Nga këto tre ushtarakë, autoritetet shqiptare duhet të përzgjidhnin vetëm një duke përdorur kritere të tjera.

Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte (neni 118 i Kushtetutës). Pikat 10.5.2 dhe 10.6 e Urdhërit Nr.1587, datë 30.09.2011 vijnë në kundërshtim me ligjin pasi përcaktojnë një autoritet vlerësimi të ndryshëm nga ai i kërkuar në ligj. Edhe nëse do të pranojmë që ky Urdhër është plotësisht i vlefshëm, nga hetimi ka rezultuar se ai nuk është zbatuar. Referuar pikës 10.6 të Rregullores, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm duhet të paraqesë për miratim të Ministri i Mbrojtjes vetëm një nga kandidaturat. Ndërkohë rezulton nga shkresa e Shtabit të Përgjithshëm Nr.8809/1 datë 04.12.2013 se, Ministrit të Mbrojtjes i janë paraqitur për miratim dy kandidatura. Gjithashtu nuk është e qartë se çfarë kriteri është përdorur nga Ministri i Mbrojtjes për të përzgjedhur nga dy kandidaturat e paraqitura. Në shpjegimet e Ministrisë së Mbrojtjes thuhet se është përdorur si kriter i veçantë formulari i vlerësimit vjetor të ushtarakut dhe të dhënat personale por, nuk na është dhënë ndonjë sqarim për procedurën se si janë vlerësuar këto kritere.

Major F. A. ka depozituar ankesë në Ministrinë e Mbrojtjes në datën 07.12.2013. Referuar dokumentacionit që na është vënë në dispozicion rezulton se, Ministria e Mbrojtjes ka kthyer përgjigje jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh (neni 27 i Ligjit “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA”). Me shkresën Nr.22/3, datë 17.03.2014, Drejtoria e Inspeksionit të Përgjithshëm dhe Antikorrupsionit, sqaron ushtarakun se midis kandidaturave të paraqitura për

miratim i është dhënë prioritet kandidates femër. Ky kriter nuk gjen mbështetje ligjor dhe është i ndryshëm nga kriteret përzgjedhëse që Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes na kanë pohuar se janë zbatuar për këtë rast.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

J U R E K O M A N D O J M Ë:

1. Zbatimi i dispozitave ligjore për rastet e vlerësimit të ushtarakëve që do të kualifikohen jashtë vendit;
2. Ndryshimin e Urdhërit Nr.1587, datë 30.09.2011 *“Politikat dhe procedurat standard të veprimit për menaxhimin e arsimimit dhe kualifikimit jashtë vendit të personelit të FA”* si më poshtë vijon:
 - Të hiqen pikat 10.5.2 dhe 10.6;
3. Marrja parasysh e mundësisë për të përsëritur procesin e vlerësimit të ushtarakut që do të ndjekë *“Shkollën e Luftës”*, kualifikim i organizuar nga shteti Frances.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në Mungesë dhe me Porosi

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI